



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Nr. 104/1 Prot.

Tiranë, më 8.01.2020

Lënda : Relacion sqarues mbi realizimin e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike, për vitin 2019.

TIRANË

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në mbështetje të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Ju dërgon realizimin e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike, për vitin 2019.

Fondet limit në Regjistrin e Realizimeve të Prokurimeve Publike dhe vlerat e kontratave të lidhura, janë pasqyruar për vlerat pa tvsh.

1. Realizimi i Regjistrit për grupin e shpenzimeve në zërin investime (231).

Gjithsej fondi i planifikuar i investimeve për vitin 2019, është 3 milion lekë dhe për periudhën respektive 12-mujore, është realizuar prokurimi në vlerën 50% e fondit të planifikuar për vitin 2019.

Inspektorati i Lartë, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi dhe të planifikimit në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike të vitit 2019, për periudhën e raportimit, ka prokuruar fondet e planifikuara të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit si më poshtë;

1. Fondi i investimeve me objekt "*Blerje pajisje elektronike dhe zyre*", miratuar si produkt nga Ministria e Financave, me fond limit në vlerën 1,500,000 lekë, është prokuruar, me procedurën "*Kërkesë për Propozim*", dhe është fituar nga operatori ekonomik "*BNT ELECTRONICS*" Shpk, në vlerën 1,061,400 lekë ose 71% të fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer në zbatim të detyrimeve të kontratës dypalëshe nr.3346 prot, datë 19.6.2019.

2. Fondi i investimeve me objekt “Sistem Audio Prezantimi i Blerë” me fond limit 1,500,000 lekë me tvsh, miratuar si produkt nga Ministria e Financave, me fond limit në vlerën 1,500,000 lekë, është prokuruar, me procedurën “Kërkesë për propozim”. Pas realizimit të procedurave të prokurimit dhe gjatë afateve të ankimit, në zbatim të nenit 24 pika 1, gërma a) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, si dhe Shkresës nr.2192 prot, datë 2.12.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, procedura e prokurimit u anulua, si rezultat i ndalimit të menjëhershëm të nënshkrimit të kontratave të reja, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

II.Realizimi i Regjistrit për grupin e shpenzimeve në zërin operative (602).

Realizimi i Regjistrit të Prokurimeve për grupin e shpenzimeve operative për vitin 2019, evidenton prokurimin gjithsej të fondit limit prej 12,108,242 lekë me tvsh. Gjithsej është realizuar vlera 10,919,833 lekë me tvsh ose 90% e fondit limit të planifikuar me tvsh për periudhën respektive, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

1. Fondi i parashikuar për grup artikullin shërbimi me objekt ‘Shërbimi i ruajtjes me roje civile’ është prokuruar në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 33, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu IV, neni 36. Për nevojat e sigurisë të godinës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave institucionit për vitin 2019, për shërbimin e ruajtjes me roje civile është realizuar tenderi me procedurën “Kërkesë me Propozim” me fond limit 3,369,603 (tre milion e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tre) lekë pa tvsh, me Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj, nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes kuadër. Tenderi është fituar nga operatori ekonomik “AK, Trezhnjeva” shpk, në vlerën 3,160,218.16 (tremilion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë, pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë pa tvsh dhe 3,792,261.79, (tre milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një, pikë shtatëdhjetë e nëntë) lekë me tvsh.
2. Fondi i parashikuar për grup artikullin “Blerje materiale kancelarie”, me fond limit për 750,000 (shtatëqind e pesëdhjetëmijë) lekë, pa tvsh, është realizuar me procedurën e blerjes me vlerë të vogël dhe është fituar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k në vlerën 721,000 (shtatëqind e njëzeenjëmijë) lekë pa tvsh ose 96% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konformë specifikimeve teknike të kërkuara.

3. Fondi i parashikuar për grup artikullin "Shërbim për riparim/mirëmbajtje për 3 automjete të ILDKPKI", me fond limit për 416,667 (katëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa tvsh, është realizuar me procedurën e blerjes me vlerë të vogël dhe është fituar nga operatori ekonomik "Servis –Auto 2000" sh.p.k në vlerën 389,600 (treqind e tetëdhjetë e nëntëmijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh ose 93.5% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konformë specifikimeve teknike të kërkuara.
4. Fondi i parashikuar për grup artikullin "Blerje Karburant", me fond limit për 750,000 (shtatëqind e pesëdhjetëmijë) lekë, pa tvsh, është realizuar me procedurën e blerjes me vlerë të vogël dhe është fituar nga operatori ekonomik "Kastrati" shpk në vlerën 696,729.17 (gjashtëqind e nëntëdhjetëegjashtë mijë e shtatëqindenzetenëntë pikë shtatëmbëdhjetë) lekë pa tvsh ose 92.8% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konformë specifikimeve teknike të kërkuara dhe kushteve të përcaktuara në kontratën dypalëshe nr.1976 Prot., datë 7.03.2019.
5. Fondi i parashikuar për grup artikullin "Blerje tonera për printera dhe fotokopje" me fond limit për 1,583,333 (një million e pesëqindetëdhjetëetremijë e treqindetridhjetëetretë) lekë, pa tvsh, është realizuar me procedurën e prokurimit "Kërkesë për Propozim" dhe është fituar nga operatori ekonomik "Infosoft Office" sh.p.k në vlerën 1,537,252.71 (një million e pesëqindetridhjetëeshtatë mijë e dyqindpesëdhjetëedy pikë shtatëdhjetëenjë) lekë pa tvsh ose 97% e fondit të planifikuar. Likujdimi është kryer konformë specifikimeve teknike të kërkuara dhe kushteve të përcaktuara në kontratën dypalëshe nr.4514, datë 27.11.2019.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar në përmbushjen e detyrimeve me shtetin shpenzime si posta, energji, ujë, telefoni. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë lidhur kontrata shpenzim i abonimit në shtyp, siguracione të detyrueshme për automjetet e ILDKPKI, kontrata e shërbimit të mirëmbajtjes së ashensorit, larjes së automjeteve etj. të cilat institucioni i likujdon, në mbështetje të specifikimeve teknike të sanksionuara në marrëveshjet dypalëshe.

Përsa i përket shpenzimeve për blerje mallra të natyrave të ndryshme, institucioni për këtë periudhë, i ka prokuruar dhe realizuar sipas nevojave konkrete, në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi.

Realizimi i prokurimeve të shpenzimeve të planifikuara për ILDKPKI, për vitin 2019 është mbështetur në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike të vitit 2019, të publikuar dhe kërkesave konkrete të institucionit, të kërkesave për përmirësim e mëtejshëm të punës në menaxhimin dhe zbatimin e objektivave të përcaktuara, duke zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni financiar nëpërmjet një administrimi korrekt dhe kontrolli të vazhdueshëm.

**NËPUNËS I AUTORIZUAR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Evgjeni BASHARI

